

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda, gjyqtarja Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. nga Shkodra Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit në Prizren PP.nr.120/2016 të datës 24.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B. N. nga Prizreni, me datë 20.06. 2016, publikisht morri dhe shpalli këtë

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. M., nga i ati Z. dhe e ëma D. e lindur Sh., data e lindjes... në Shkodër Republika e Shqipërisë, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor i gjendjes së varfë ekonomike, i martuar, pa fëmijë , shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, gjendet në Qendrën Korrektues në Dubravë në vuajtjen e dënimi prej 7 vjet e 9 muaj, për shkak të veprave penale të grabitjes.

ËSHTË FAJTOR

Ka përvetësuar pasurin e luajtshme të personit tjetër me qëllim që të sjellë vetes dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorur dhunën , në atë mënyrë që me datën 09.01.2012 hynë në filigranin “E.” në rrugën A. J. në Prizren, pronë e të dëmtuarit A. N., i cili fillimisht nga i dëmtuari kërkon me ja prezantuar disa lloje të stolive të arit dhe pas prezantimit të stolive, me shpejtësi nga gjepi e nxjerr sprein e biberit dhe e spërkatë fytyrën e të dëmtuarit pas nga çanta (rulo) e lëkurës me ngjyrë të zezë e vendosur mbi vitrinën ia merr tre zinxhir dore të arit dhe tre zinxhir qafe të arit, në vlerë rreth 3.000 € dhe me shpejtësi ik nga vendi i ngjarjes .

- Me këtë ka kryer veprën penale, të grabitjes nga neni 255 par. 1 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 43, 44, 45, 73, 74, 75par.1 pika1.3, 76par.1 pika 1.3, dhe neneve të përmendura më lartë të KP, e

G J Y K O N

Me dënim me burg në kohë zgjatje prej 2 (dy) vite.

I dëmtuari A. N. për realizimin e kërkesës pronësoro juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris së gjykatës ndera në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 100 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.nr.120/2016 të datës 24.05.2016, kundër të akuzuarit A. M., nga Shkodra, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 255 par. 1 të KPK.

Pas pranimit të shkresave të lëndës është caktuar shqyrtimi fillestar ku i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i Shtetit nuk ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari A. M. duke shtuar se pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë propozon që ky qëndrim i të akuzuarit të merret si rrethanë lehtësuese si dhe rrethanat se shihet qartë se i njëjti pendohet dhe ndien keqardhje për kryerjen e veprës penale. Ndërsa si rrethana rënduese duhet të marrë parasysh faktin se i njëjti edhe më parë ka kryer vepra penale të kësaj natyre i cili fakt vërtetohet me atë se i njëjti aktualisht gjendet në vuajtjen e dënimit në Qendrën Korrektuese në Durbavë.

Në bazë të pranimit të fajësisë nga i akuzuari dhe në bazë të provave nga shkresat e lëndës është vërtetuar kjo gjendje faktike:

I akuzuari është shtetas i Republikës së Shqipërisë. Ditën kritike, me datën 09.01.2012, në Prizren, ka hyrë në filigranin "E." në rrugën A. J., pronë e të dëmtuarit A. N. dhe ka përvetësuar pasurin e luajtshme të personit tjetër me qëllim që të sjellë vetes dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorur dhunën, në atë mënyrë që, fillimisht nga i dëmtuari kërkon t'i prezantohen disa lloje të stolive të arit dhe pas prezantimit të stolive, me shpejtësi nga xhepi ka nxjerrë spërkatësin dhe e spërkatë fytyrën e të dëmtuarit e pastaj nga çanta (rulo) e lëkurës me ngjyrë të zezë e vendosur mbi vitrinën ka marrë tre zinxhirë dore të arit dhe tre zinxhirë qafe të arit, në vlerë rreth 3.000 € dhe me shpejtësi është larguar nga vendi i ngjarjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. B. N. lidhur me deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë ka deklaruar se duke patur parasysh rrethanat se i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë propozon që gjatë marrjes së vendimit mbi dënimit gjykata të ketë parasysh përqindjen e paraparë me dispozitat e ligjit në raport me dënimin minimal të paraparë.

Duke pasur parasysh se në shqyrtimin fillestar, me respekt paraprak të gjithë të drejtave të akuzuarit, i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë sipas të gjithë pikat e aktakuzës në pajtim me nenin 248 par.1 të KP, i cili pranin ka të bëjë si me tërë përsëkrimin e ngjarjes, nga rrjedhin elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë, ashtu edhe me parashikimin sipas ligjit të veprës së argumentuara dhe me kualitet të tillë sa që japin fakte të cilat janë në kuadër të Ligjit. Në bazë të cekurave gjykata edhe nuk ka administruar provat dhe ka pranuar pranimin e fajësisë e të akuzuarit duke mos gjetur se ekzistojnë provat e papranueshme duke konsideruar se pranimi i fajësisë është vërtetuar me fakte të cilat janë në kuadër të fakteve të tjera të vërtetuara me provat të prezantuara të cilat prova udhëzojnë në ekzistimin e veprës penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë.

Nga të cekurat më lart gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale si në shqiptim të aktgjykimit, për të cilën vepër e ka shpallur fajtor dhe gjykuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe me vlerësimin e të gjitha rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjykata ka pasur parasysh që secila prej këtyre rrethanave veç e veç janë vlerësuar në ndërlidhje me të gjitha rrethanat e tjera të cilat ndikojnë në matjen e dënimit, në rastin konkret duke gjetur si rrethana rënduese shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur- shikuar përmes peshës së veprës së kryer duke pasur parasysh pasojën abstrakte me krijimin e kushteve që vlera e mbrojtur mund të vijë në rrezik, në rastin konkret duke pasur parasysh edhe pasojën konkrete se me përdorimin e spërkatësin ndaj të dëmtuarit është shkaktuar frika , se është recidivist për kryerjen e veprave penale të kësaj natyre, gjykata ka analizuar edhe motivin për kryerjen e veprës penale dhe ka marrë parasysh arsyet e veprimit të tillë të akuzuarit, të cilat na tregojnë për personalitetin e kryesit dhe shkallën e rrezikut shoqëror të tij si dhe të veprës së kryer në rastin konkret, se i dëmtuari ka parashtruar kërkesën pronësoro juridike ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja korrekt pranë gjykatës , është penduar për veprimet e veta me premtim se nuk do të vjen në konflikt me ligjin pos kësaj gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese e poashtu ka marrë parasysh edhe rrethanën se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë, prandaj gjykata me aplikimin e dispozitës së nenit 76 par. 1 pika 1.3 të KP, ia shqiptoi dënimin me burg si në dispozitivin e aktgjykimit , duke konsideruar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KP.
Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike është marrë në bazë të nenit 463par.2 KPP.
Nga të cekura më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
P.nr. 89/16, dt. 20.06.2016

Sekretaren juridike,
Valdete Zurnaxhiu

përkthyesja gjyqësore
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

UDHËZIMI JURIDIK: pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit nëpërmjet të kësaj gjykate – Gjykatës së Apelit në Prishtinë.